



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

Veprimtaritë e IOM në Shqipëri

Vështrim i përgjithshëm

IOM është organizata kryesore ndërqeveritare në fushën e migracionit, e cila punon e lidhur ngushtë me partnerët qeveritarë, ndërqeveritarë dhe joqeveritarë për të garantuar menaxhimin e duhur dhe human të migracionit. Objektivi kryesor i IOM Shqipërisë është mbështetja e vazhdueshme në zbatimin e plotë të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit, si dhe eksplorimi i mënyrave të asistimit të mëtejshëm të migrantëve shqiptarë. Në këtë drejtim, IOM do të mbështesë edhe dialogun për çështjet e migracionit ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë, Italisë dhe Greqisë, me qëllim rritjen e shkallës së integritimit dhe kontributit që japin migrantët në vendin e tyre. IOM do të punojë në lidhje të ngushtë me aktorët ndërkombëtarë dhe Qeverinë shqiptare për identifikimin në kohë të mënyrave me kosto sa më efektive që do të plotësonin prioritetet e çështjeve të migracionit në përputhje me strategjinë e hyrjes në BE.

Bashkëpunimi teknik për migracionin

IOM ka mbështetur Qeverinë Shqiptare në hartimin e "Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Migracionin", që përbën një dokument kombëtar politikash gjithëpërfshirëse që synojnë menaxhimin e migracionit në Shqipëri, miratuar në vitin 2005. Aktualisht, IOM ofron asistencë dhe ekspertizë për mbështetjen e zbatimit efikas të 16 masave të Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin lidhur me shkaqet kryesore të migracionit, kthimin dhe rinteigrimin e suksesshëm të migrantëve shqiptarë, promovimin e lidhjeve ndërmjet migracionit dhe zhvillimit, si dhe hartimin e kuadrit të përshtatshëm ligjor dhe institucional për emigracionin dhe imigracionin. Gjithashtu, IOM vazhdon të ndihmojë Qeverinë shqiptare për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Ripranimit të Shqipërisë (MR) me KE, ratifikuar nga Parlamenti shqiptar në datën 1 maj 2006. Në mënyrë të veçantë, organizata ndihmon në forcimin e institucioneve shqiptare për zbatimin e klauzolës së MR për vendet e treta, që do të hyjë në fuqi në vitin 2008. Zbatimi i Marrëveshjes së Ripranimit konsiderohet si prioritet nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (MSA).

Anti-trafikimi

Dy elementet kyçe të kontributit të IOM në përpjekjet për anti-trafikimin janë ndihma e drejtpërdrejtë dhe transferimi i ekspertizës. Që prej vitit 1999, organizata ka ndihmuar në kthimin, rehabilitimin dhe rinteigrimin e rreth 700 viktimave shqiptare dhe jo shqiptare të trafikimit, në bashkëpunim me Kordinatorin Kombëtar për Anti-Trafikimin, Policinë Kufitare dhe të Anti-Trafikimit, Shërbimet Sociale Shtetërore, Qendrën Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit, si dhe me ofrues të tjerë shërbimesh jo qeveritarë.

IOM punon jo vetëm për mbështetjen e veprimtarive ndërgjegjësuese, identifikimin dhe adresimin e problemeve të njerëzve në nevojë, por kontribuon edhe në kordinimin e aktorëve të përfshirë në luftën kundër fenomenit të trafikimit në të gjitha aspektet e tij të dëmshme. Duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi, fushatat ndërgjegjësuese të IOM për luftën kundër trafikimit, jo vetëm që plotësojnë boshllëqet në informacionin për fenomenin e trafikimit, por synojnë të sjellin edhe ndryshime në sjellje.

IOM është gjithashtu shumë i angazhuar në mbështetjen e Strategjisë Kombëtare për Anti-Trafikimin dhe Planit të Veprimit, Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Standardeve Kombëtare të Asistimit të viktimave të trafikimit. IOM do të vazhdojë të mbështesë Qeverinë dhe ofruesit e shërbimeve në nivel lokal për krijimin dhe ruajtjen e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe parandalimin e këtij fenomeni.

Kthimi Vullnetar i Asistuar dhe Rinteigrimi

Kthimi Vullnetar i Asistuar është një prej shumë shërbimeve për menaxhimin e migracionit që IOM u ofron migrantëve dhe qeverive. Ai synon kthimin e rregullt, human dhe me kosto efektive, si dhe në rinteigrimin e migrantëve që dëshirojnë të kthehen vullnetarisht në vendet e tyre të origjinës.

Në kuadër të Programit për Kthimin Vullnetar të Asistuar dhe Rinteigrimin, IOM ka ndihmuar 450 emigrantë të kthyer nga Anglia, duke ofruar mbështetje për lehtësimin e kthimit dhe rinteigrimit të tyre në vend. Është hartuar një paketë e plotë asistencë në kthim dhe rinteigrim për lehtësimin e procesit, si dhe për të plotësuar nevojat specifike të individëve.

Migracioni dhe zhvillimi

Në përputhje me masat e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit, IOM ka ndërmarrë studime të ndryshme të cilat hedhin dritë mbi përdorimin e dërgesave në para të emigrantëve dhe ndikimin e tyre në vend. Si anëtar aktiv i Grupit Ndërinstitucional të Punës të krijuar në vitin 2006 në kuadër të një nisme të përbashkët mes IOM dhe ILO të financuar nga Qeveria Italiane, IOM kontribuoi në hartimin e draft Planit Kombëtar të Veprimit për Dërgesat në Para të Emigrantëve. Ky Plan Veprimi i cili përmban 8 masa specifike të cilat synojnë të rrisin ndikimin social dhe ekonomik të dërgesave në para të emigrantëve në Shqipëri, reflekton punën e përbashkët të institucioneve të ndryshme, përfshi agjensitë qeveritare, bankat private, etj. Versioni final i draft Planit Kombëtar të Veprimit për Dërgesat në Para të Emigrantëve është aktualisht në fazën e rishikimit përfundimtar nga Qeveria, përpara se të bëhet miratimi i tij. Gjatë vitit 2007, IOM në bashkëpunim me shërbimin konsullor shqiptar në Greqi, Itali dhe Agjensinë Albinvest organizuan një sërë aktivitësh me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të emigrantëve shqiptarë mbi kanalet e ndryshme të transferimit të dërgesave të tyre në para dhe mundësitë e investimit në Shqipëri. Gjithashtu u krijua edhe një faqe web mbi "Migracionin dhe Zhvillimin" në faqen e internetit të IOM Tiranës: www.iomtirana.org.al

Arritjet kryesore në vite:

1992 – IOM hap Misionin në Shqipëri

1992 – Shqipëria aderon në IOM me statusin e Shtetit Vëzhgues

1993 – Shqipëria bëhet Shtet Anëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin

1999 – IOM punon me Qeverinë Shqiptare për të ndihmuar njerëzit e shpërngulur nga Kosova për shkak të luftës dhe spastrimit etnik

Nëntor 1999 – IOM, në bashkëpunim me ICMC, ngre qendrën e pare në Shqipëri për pritjen e viktimeve të trafikimit nga vende të treta

2001 – IOM mbështet Qeverinë Shqiptare në hartimin e Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Shkurt 2002 – IOM ngre Qendrën e Riintegritimit për viktimat shqiptare të trafikimit

Korrik 2002 – IOM inauguron Qendrën e Shërbimit për Migrantët, me qëllim ndihmesën e migrantëve potencialë shqiptar për të patur akses në informacionin për migracionin

Qershor 2002 – IOM ngre një qendër për pritjen e migrantëve të parregullt të ndaluar në Shqipëri, si dhe për viktimat e trafikimit nga vende të treta

Korrik 2003 – IOM asiston Qeverinë Shqiptare në ngritjen e Qendrës së Parë Shtetërore Kombëtare për pritjen e viktimeve vendase të trafikimit, viktimeve të trafikimit të vendeve të treta, si dhe migrantëve të parregullt të ndaluar në Shqipëri

Nëntor 2004 – IOM asiston në krijimin e OFJ-së “Different & Equal” – “Të ndryshëm dhe të barabartë” për asistimin në riintegrimin e viktimeve vendase të trafikimit

Maj 2005 – Këshilli i Ministrave i Shqipërisë miraton Planin Kombëtar të Veprimit për Migracionin, i hartuar me mbështetjen e IOM

Korrik 2005 – Qeveria Shqiptare miraton “Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Mekanizmi Referues Kombëtar për nxitjen e identifikimit dhe asistimit të Viktimeve të Trafikimit”, e hartuar nga IOM

Gusht 2005 – IOM implementon një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim parandalimin e HIV/AIDS, me përfshirjen e artistëve dhe futbollistëve të mirënjohur

Mars 2006 – IOM nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit me Qeverinë Shqiptare dhe aktorë të tjerë për “Marrjen në dorëzim të sistemit të përzgjedhjes së të huajve të parregullt dhe azilkërkuesve në Shqipëri”

Maj 2006 – IOM, në bashkëpunim me partneret inauguron rikonstrukcionin e ambienteve të Policisë Kufitare në Sarandë, që shënon qendrën e 11 të rikonstruktuar në kuadër të implementimit të projektit të përzgjedhjes

Korrik 2006 – IOM lançon fushatën informuese “Migracioni i Sigurt është një Zgjedhje dhe një Mundësi”, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet që lidhen me migracionin e parregullt

Nëntor 2006 – IOM, në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin Kombëtar për Anti-Trafikimin dhe UNODC, ngre linjën e parë telefonike kombëtare pa pagesë që ofron shërbime për migracionin e rregullt dhe antitrafikimin

Shkurt 2007 – IOM lançon një projekt që synon zbatimin e mëtejshëm të Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin

Qershor 2007 – Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit, IOM mbështet hartimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Remitancat”





IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

Activities of IOM Albania

Overview

IOM is the leading inter-governmental organization in the field of migration, and works closely with governmental, intergovernmental and non-governmental partners to ensure the orderly and humane management of migration.

IOM Albania's main goal is to continue to support the full implementation of the National Strategy on Migration and its Action Plan, as well as to seek ways of assisting the Albanian migrants whenever possible. In this connection, IOM will also support a migratory dialogue between Albania and its main partners, Italy and Greece, so as to boost both local integration and contribution by migrants to their country. IOM will work closely with international stakeholders and the government of Albania to identify timely and cost-effective ways to meet migratory priorities in line with the EU alignment strategy.

Technical cooperation on migration

IOM has supported the Albanian government to elaborate a comprehensive policy document aimed at managing migration in Albania the "National Strategy on Migration and National Action Plan on Migration" approved by the Albanian Government in 2005. At present IOM provides technical assistance and expertise in support of the efficient implementation of 16 measures of the Albanian National Action Plan on Migration related to addressing the root causes of migration, the successful return and reintegration of Albanian migrants, the promotion of the link between migration and development, and the elaboration of an appropriate legal and institutional framework for emigration and immigration.

IOM also continues to provide assistance to the government of Albania to implement the obligations that stem from the EC/Albania Readmission Agreement (RA), ratified by the Albanian Parliament on 1st May 2006. In particular, the organization facilitates the strengthening of the Albanian institutions to implement the third country clause of the RA, which will enter into force in 2008. The implementation of the Readmission Agreement is considered a priority under the Stabilization and Association Agreement (SAA).

Counter-trafficking

Direct assistance and transfer of "know-how" are two key elements of IOM's contribution to Albania's counter-trafficking efforts. Since 1999 the organization has assisted the return, rehabilitation and reintegration of around 700 Albanian and non Albanian victims of trafficking through joint work with the Anti-trafficking National Coordinator, the Anti-trafficking and Border Police, the State Social Services, the National Reception Center for Victims of Trafficking, as well as other nongovernmental service providers.

IOM Tirana works not only to support awareness-raising activities, identification of and addressing of needs of those in need, but also contributes to the coordination efforts among the actors involved in combating the phenomenon of trafficking in all its harmful aspects. Using different channels of communication, IOM counter-trafficking information campaigns not only fill gaps of information on the trafficking phenomenon, but aim to bring about behavioral changes.

IOM is also strongly committed to supporting the National Strategy for Combating Trafficking in Human Beings, the National Referral Mechanism and the National Standards of Assistance to victims of trafficking, in line with international standards. IOM will continue to support the government and local service providers in setting and maintaining international standards for the protection of victims of trafficking and the prevention thereof.

Assisted Voluntary Return and Reintegration

Assisted Voluntary Return (AVR) is one of many migration management services IOM offers to migrants and governments. It aims at orderly, humane and cost-effective return and reintegration of migrants who wish to return voluntarily to their countries of origin.

Specifically under the Voluntary Assisted Return and Reintegration Programme (VARRP), IOM has assisted 450 returnees from the U.K., providing support to facilitate their return to, and reintegration in their home country. A comprehensive return and reintegration assistance package has been developed to facilitate the process and meet individuals' specific needs.

Migration and Development

In line with the provisions of the National Strategy on Migration and its Action Plan, IOM has carried out several studies which have shed light on remittance use, and remittance impact in Albania. As an active member of an Interagency Working Group established in 2006 in the framework of an IOM/ILO initiative funded by the Italian Government, IOM contributed to the elaboration of the draft National Action Plan on Remittances. The Action Plan which contains 8 specific measures aimed at enhancing the social and economic impact of migrant remittances in Albania, reflects the joint work of various institutions, including government agencies, private banks etc. The final version of the Draft National Action Plan on Remittances is currently under final revision by the Government before final endorsement takes place. During 2007, IOM in close cooperation with the Albanian consular service in Greece and Italy, and the AlInvest Agency organized various activities in order to raise awareness of Albanian migrants about different channelling of remittances and investment opportunities in Albania. A web page on "Migration and Development" was also hosted in the IOM Tirana website: www.iomtirana.org.al.

Main achievements through the years:

1992 – IOM opens its Mission in Albania

1992 – Albania joins IOM as an Observer State

1993 – Albania becomes a Member State of the International Organization for Migration

1999 – IOM works with the Albanian Government to provide support to displaced Kosovo people due to the war and ethnic cleansing

November 1999 – IOM, in cooperation with ICMC establishes the first reception center in Albania for third country national victims of trafficking

2001 – IOM supports the Albanian Government to draft a National Strategy to combat trafficking of human beings

February 2002 - IOM establishes the Reintegration Center for Albanian victims of trafficking

July 2002 – IOM inaugurates the Migrant Service Centre to facilitate Albanian potential migrants access to informed migration

June 2002 - IOM establishes a reception center for irregular migrants stranded in Albania and for third country national victims of trafficking

July 2003 - IOM assists the government of Albania in the establishment of the first state owned National Reception Center for local and third country national victims of trafficking and irregular migrants stranded in Albania

November 2004 - IOM assists in setting up the NGO “Different & Equal” for the reintegration assistance of local victims of trafficking

May 2005 – The Albanian Council of Ministers approves the National Strategy on Migration and National Action Plan on Migration drafted with IOM support

July 2005 – The Albanian government approves the “Cooperation Agreement on the National Referral Mechanism for Enhancing Identification of, and rendering assistance to, Victims of Trafficking” established by IOM

August 2005 – IOM implements an awareness raising campaign through the involvement of well-known artists and footballers aimed at HIV/AIDS prevention

March 2006 - IOM signs a Memorandum of Understanding with the Albanian government and stakeholders on “Handover of Prescreening System of Irregular Foreigners and Asylum Seekers in Albania”.

May 2006 – IOM, in collaboration with pre-screening actors and Albanian Ministry of Interior, inaugurates the rehabilitation of Saranda Border Police premises, marking the 11th center rehabilitated in the framework of the implementation of the project on pre-screening

July 2006 - IOM launches the information campaign “Safe Migration is a Choice and an Opportunity” to raise awareness about risks associated with irregular migration

November 2006 – IOM, in close co-operation with the National Coordinator for Anti-Trafficking and UNODC, establishes the first toll-free National Helpline offering services on safe migration and counter-trafficking

February 2007 – IOM launches a project aimed at the further implementation of the National Action Plan on Migration

June 2007 – In compliance with the National Strategy on Migration and its Action Plan, IOM supports the drafting of the “National Action Plan on Remittances”

